

Bashkia Mike e Fëmijëve

2023 -2025

PËRMBAJTJA

ÇFARË ËSHTË INICIATIVA BASHKI MIKE E FËMIJËVE	3
OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET	7
SEKSIONI 1 -PLANI I VEPRIMIT	17
SEKSIONI 2 – KOMITETI DREJTUES	29
SEKSIONI 3 – KËSHILLI KONSULTATIV I FËMIJËVE (KKF)	31
SEKSIONI 4 – HOTELET DHE RESTORANTET MIQESORE ME FEMIJET	33
SEKSIONI 5 – RAPORTIMI VJETOR I INICIATIVËS: SEKSIONET KRYESORE.....	36
SEKSIONI 6 – LISTA E PIKAVE FOKALE TË ZBATIMIT TË PLANIT	37
SEKSIONI 7 – PLANI I THJESHTË I KOMUNIKIMIT	39
SEKSIONI 8 – INSTRUMENTAT PER MATJEN E PERCEPTIMEVE	40
SEKSIONI 9 – MEMORANDUMI I MIREKUPTIMIT	52

ÇFARË ËSHTË INICIATIVA BASHKI MIKE E FËMIJËVE

Bashkia “Mike e Fëmijëve (Adoleshentëve)” është një iniciativë, ku bashkia zbatuese angazhohet për të përmirësuar jetën e fëmijëve brenda juridiksionit të tyre duke realizuar të drejtat e tyre siç janë artikuluar në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe me specifikisht në nenet kryesore që janë: interesi më i mirë i fëmijës; mosdiskriminimi; zbatimi i të drejtave, pjesëmarrja dhe zotërimi i proceseve; jeta dhe mbijetesa; si dhe respektimi i zërit të tyre.

Në praktikë, kjo iniciativë është një bashki, komunitet ose njësi administrative apo çdo njësi të qeverisjes vendore, në të cilën zërat, nevojat, prioritetet dhe të drejtat e fëmijëve janë pjesë përbërëse e politikave, programeve dhe vendimeve publike. Vizioni është që çdo fëmijë dhe adoleshent të shijojë fëmijërinë e tij dhe të arrijë potencialin e plotë brenda bashkive/komuniteteve të tyre.

Fushat kryesore të ndërhyrjes

- Qeverisje e mirë lokale e bazuar në:
 - Sisteme të përmirësuara për politik bërje, buxhetim dhe monitorim.
 - Planifikime bazuar në evidencë dhe monitorim të vendimeve lokale.
 - Angazhime efikase të përfituesve dhe aktorëve të tjerë.
- Mjedise të sigurtë, të pastë dhe të mbrojtur:
 - Lëvizja e sigurtë dhe e pavarur.
 - Mjedise të pastra dhe të gjelbërta.
- Loja dhe koha e lirë
 - Hapësira të aksesueshme për lojë dhe kohën e lirë
 - Standardet dhe mekanizmat e sigurisë
- Mjedis mundësues
 - Gjithpërfshirja dhe pjesëmarrja
 - Inovacioni dhe teknologjia

Objektiva e iniciativës

Nisma do të ndihmojë Bashkinë Korçë të prioritetizojë dhe masë punën për përfshirjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijës në planet e saj vendore, monitorimin dhe përditësimin e tyre bazuar në evidencë, si dhe angazhimin efikas të përfituesve dhe palëve të interesuara për të rritur sinergjinë e veprimeve.

Strategjitë kryesore

- Krijimi i sinergjive mes strukturave vendimarrëse që kanë në qendër fëmijë, adoleshente, të rinj, vlerësimi i situatës
- Planifikimi dhe buxhetimi strategjik me fokus fëmijët dhe adoleshentët.
- Monitorimi i vazhdueshëm dhe mbledhja e të dhënave për që tregojnë situatën e fëmijëve.
- Marrja e masave aktive për të reduktuar/eliminuar diskriminimin.
- Komunikimi i vazhdueshëm, ndërgjegjësimi dhe advokimi për të drejtat e fëmijëve.

Roli i bashkisë Korçë

Bashkia Korçë në bashkëpunim me UNICEF Shqipëri, do të:

- Koordinojë dhe nënshkruajë Memorandum Mirëkuptimi (MM).
- Koordinimi i zhvillimit të analizës së situatës së të drejtave të fëmijëve në konsultim me fëmijët, adoleshentët dhe aktorët kryesorë në bashkinë/komunitetin specifik.
- Koordinimi i hartimit të Planit të Veprimit dhe angazhimi i palëve të interesuara për të siguruar buxhetin e nevojshëm për të garantuar zbatimin e planit.
- Finalizimi i planit vendor të veprimit dhe miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak;
- Në koordinim me UNICEF-in në Shqipëri, Bashkia Korçë përcakton rolet/personat koordinues që do të përfaqësojnë iniciativën (njësia koordinuese lokale).
- Monitorimi i progresit dhe gjenerimi i dëshmive për të identifikuar dhe adresuar mundësitë dhe sfidat e mundshme gjatë zbatimit.

Roli i UNICEF Shqipëri

UNICEF Shqipëri do të mbikëqyrë dhe koordinojë nismën në nivel kombëtar. Roli i tij do të përfshijë:

- Përcaktimin e prioriteteve të përgjithshme kombëtare për nismën dhe objektivat kombëtare sipas qasjes metodologjike të miratuar.
- Finalizimin e modelit të iniciativës që do të përdoret më tej për vlerësimin dhe njohjen e bashkive miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.
- Miratimin e planeve lokale të veprimit të hartuara nga bashkitë candidate, bazuar në kriteret e paracaktuara dhe prioritetet e përcaktuara në nivel kombëtar.
- Përcaktimin e kornizës dhe procesin e monitorimit dhe vlerësimit për bashkitë dhe komunitetet pjesëmarrëse.
- Njih bashkitë/komunitetet miqësore për fëmijët dhe adoleshentët.

Cikli i zbatimit



Memorandumi i Mirëkuptimit

Zhvillohet dhe lidhet memorandumi i mirëkuptimit me bashkinë kandidate për zbatimin e iniciativës.



Analiza e Situatës

Zhvillohet analiza e situatës së të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve në Bashkinë kandidate duke ekzaminuar statistikën, politikat lokale, ligjet dhe hulumtimet ekzistuese të lidhura me situatën dhe mirëqenien e fëmijëve dhe adoleshentëve. Kjo analizë lehtëson të kuptuarit e kontekstit, plotësimin e roleve dhe proceseve vendimmarrëse të qeverisjes vendore dhe aktorëve të tjerë në nivel vendor dhe nxjerr në pah fushat më të rëndësishme të shqetësimit për fëmijët dhe adoleshentët, shkaqet kryesore dhe atë që fëmijët dhe adoleshentët duan të ndryshojnë. Analiza do të informojë zhvillimin e Planit Lokal të Veprimit, do të vendosë bazat mbi të cilat do të monitorohet dhe vlerësohet progresi dhe impakti, do të ofrojë dëshmi për politikëbërjen dhe do të identifikojë nevojat për zhvillimin e kapaciteteve lokale. Analiza e situatës mbështet qeveritë vendore në identifikimin e sfidave lokale të të drejtave të fëmijëve, çfarë pasojash kanë për fëmijët dhe adoleshentët dhe ndryshimet dhe rezultatet e parashikuara.



Ngritja e mekanizmit lokal kordinues

(i) Krijohet Komiteti drejtues i iniciativës, i cili ofron udhëzime dhe drejtime të përgjithshme mbi zbatimin e saj, dhe më konkretisht miraton planin e vprimit dhe buxhetin vendor të iniciativës; identifikon personin koordinues për rolin e sekretariatit dhe monitorin progresin dhe identifikon dhe adreson mundësitë dhe sfidat e mundshme.

(ii) Krijohet këshilli konsultativ i fëmijëve (Fëmijët dhe Adoleshentët) i cili ofron një mekanizëm formal për të nxitur dhe zbatuar pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrjen e qeverisjes vendore. Si përfaqësues (zëri) i fëmijëve, Këshilli mund të përdoret si një iniciativë miqësore me fëmijët dhe adoleshentët, duke hartuar politikat pjesëmarrëse dhe përfshirjen e qytetarëve të fëmijëve dhe të rinjve në komunitetet ku ata jetojnë.



Finalizimi/Aprovimi i Planit

Zhvillohet korniza e veprimit, prioritizimi i qëllimeve dhe zhvillimi i Planit të Veprimit (2 deri në 5 vjet) bazuar në gjetjet e analizës së situatës. Hapat kyç janë formulimi i një teorie ndryshimi, zhvillimi i një kuadri logjik me tregues për të monitoruar progresin dhe ndikimin, dhe identifikimi i roleve, përgjegjësive dhe afateve, si dhe burimeve (ndarja e buxhetit) për aktivitetet në Planin e Veprimit. Planet e Veprimit do të përqendrohen në fushat e synimeve kryesore të përcaktuara dhe janë ato më urgjente, përmes masave që janë në kompetencë dhe mandat të autoriteteve të bashkive përkatëse. Konkretisht, Plani i Veprimit përcakton objektivat, aktivitetet,

treguesit me bazat dhe objektivat, afatet kohore dhe ndarjen buxhetore për çdo fushë dhe aktivitet për të siguruar angazhimin e duhur financiar dhe të burimeve njerëzore. Rolet dhe përgjegjësitë duhet të përcaktohen qartë për të siguruar përgjegjësitë për zbatimin dhe monitorimin. Koordinimi ndërsektorial është çelësi integral. Një konsensus i gjerë lokal duhet të arrihet përmes një procesi konsultativ.



Zbatimi i Planit të Veprimit

Pasi Plani i Veprimit finalizohet dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak dhe UNICF Shqipëri, faza tjetër është fillimi i zbatimit dhe përmbushja e objektivave të identifikuar në fushat përkatëse, me fokus në përmbushjen e afateve të dakorduara dhe respektimin e buxheteve në dispozicion.



Monitorimi i progresit dhe gjenerimi i evidencave

Mblidhen të dhëna vjetore për qëllime monitorimi nga Njësia Koordinuese lokale me mbështetjen e aktorëve të ndryshëm kyç, sipas përgjegjësi të përcaktuara në Planin e Veprimit. Kjo punë do të integrohet sa më shumë që të jetë e mundur në proceset ekzistuese lokale për mbledhjen e të dhënave. Ekzistenca e të dhënave cilësore është gjithashtu e rëndësishme sepse ato mund të ofrojnë shembuj dhe tregime ilustruese se çfarë ka ndryshuar, pse ka ndryshuar dhe çfarë ndikimi ka pasur në të drejtat dhe jetën e fëmijëve. Një analizë e gjetjeve duhet të kryhet çdo vit (nga njësia koordinuese lokale ose partneri i caktuar) për të vlerësuar progresin e bërë drejt objektivave dhe treguesve të rënë dakord në Planin e Veprimit në formën e një raporti..



Vlerësimi

Bëhet vlerësimi i pavarur i zbatimit të Planit të Veprimit në fund të ciklit për të matur progresin dhe ndikimin e tij në nivel lokal. Vlerësimi do të vlerësojë arritjet e synuara dhe të pasyruara dhe do të hetojë arsyet pse disa aspekte të zbatimit janë zbatuar ose nuk janë zbatuar siç është planifikuar. Autoritetet vendore do të ndajnë gjetjet në publik për të vazhduar nismën dhe komitetet vendore me mbështetjen teknike të njësive koordinuese do të rishikojnë treguesit duke mbajtur treguesit përkatës që ofrojnë dëshmi përkatëse dhe mund të përfshihen tregues të rinj që janë bërë të rëndësishëm. Gjetjet do të shpërndahen në formën e një raporti miqësor për fëmijët dhe adoleshëntët.

OBJEKTIVAT DHE AKTIVITETET

Qëllimi 1: Çdo fëmijë dhe adoleshent ka mundësi për të kontribuar në proceset vendim-marrëse që ndikojnë tek ta

Objektivi 1.1 Fëmijët kanë mundësitë dhe platformat për të influencuar vendimet që ndikojnë tek ta.

Aktiviteti 1.1.1 KKF përcaktohet/rinovohet çdo vit (angazhimi i fëmijëve pjesëmarrës, trajnimi, dakordësimi mbi aktivitetet gjatë vitit)

Përshkrimi: Këshilli konsultativ i fëmijëve (KKF) pranë bashkisë Korçë, do të shërbejë si një forum diskutativ mes fëmijëve, këshillit bashkiak dhe organizmave të tjerë aktivë që janë të angazhuar në hartimin e programeve dhe politikave lokale që afektojnë fëmijët/adoleshentët. Fëmijët përfaqësues nga shkollat e bashkisë, (sëbashku me një grup përfaqësimi nga grupet vulnerable) mbidhen në fillim të vitit akademik dhe diskutojnë rreth rëndësisë së përfaqësimit të zërit të tyre në këshillin bashkiak, apo procese të tjera vendimmarrëse në lidhje me nevojat e tyre. Në këtë fazë grupi i fëmijëve zgjedh edhe përfaqësuesit që do t'i përfaqësojnë në takime të ndryshme gjatë zbatimit të iniciativës. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Arsimit dhe organizatat lokale është shumë e rëndësishme për të siguruar që këshilli konsultativ është përfaqësues i grupeve në nevojë.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet e aktiviteteve

Aktiviteti 1.1.2 Takime vjetore të këshillit konsultativ të fëmijëve

Përshkrimi. Si pjesë edhe e procesit fuqizues të fëmijëve, do të kryhen takime të ndryshme me organizmat kryesorë të bashkisë ku fëmijët diskutojnë dhe marrin iniciativa për të propozuar ndërhyrje dhe projekte që lidhen me nevojat që ata kanë. Do të organizohen takime me këshillin bashkiak pranë të cilit do të prezantohen disa prioritete që fëmijët kanë në Bashkinë Korçë; me bordin e Qytetit Miqësor të Fëmijëve; dhe me Komitetin drejtues të iniciativës. Fokusi kryesor i takimeve vjetore do të jetë influencimi i procesit të buxhetimit lokal.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet e aktiviteteve

Aktiviteti 1.1.3 Organizimi i dy takimeve (vjetore) për të mbledhur opinionet e gjera të fëmijëve (boot camps) për të ndikuar në buxhetin vjetor të bashkisë

Përshkrimi: Nën koordinimin e bashkisë dhe zyrës vendore arsimore, fëmijët pjesë e KKF do të marrin pjesë në dy trajnime gjatë të cilave ata do të aftësohen për të shprehur pikëpamjet dhe opinionet e tyre, të cilat të merren serizosht nga politikbërësit. Fëmijët do të aftësohen për të qënë pjesëmarrës aktiv në procesin e buxhetimit të bashkisë në mënyrë të përshtatshme për moshën, dhe statusin e çështjes së tyre.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet e trajnimeve

Aktiviteti 1.1.4 Zhvillimi dhe zbatimi i aktiviteteve për të promovuar dhe angazhuar U-Reporters (adoleshentët/të rinjtë) në Bashkinë Korçë

Arsyeja kryesore për këtë program është t'u ofrojë adoleshentëve dhe të rinjve një platformë për të shprehur mendimet e tyre në kohë dhe në mënyrë efektive, dhe për të ndikuar në politikat që ndikojnë

në jetën dhe të drejtat e tyre. Monitorimi dhe vlerësimi i politikave të qeverisë nga të rinjtë mund të arrihet duke përdorur në mënyrë aktive sondazhin e U-Report. Të dhënat do të kenë rëndësi kur zëri dhe opinionet shpërndahen dhe diskutohen gjerësisht me palët e interesuara, publikun dhe të rinjtë. Për t'u siguruar që U-Report përdoret rregullisht nga të rinjtë dhe zëri/opinionet e tyre ndihmon në formimin e politikave dhe programeve, Bashkia do të bashkëpunojë me Organizata partnere për të zbatuar këtë iniciativë.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet e trajnimeve

Objektivi 1.2 Fëmijët dhe adoleshentët përfitojnë nga politika vendore të orientuara nga nevojat e tyre

Aktiviteti 1.2.1 Monitorimi i zbatimit të Planit lokal social, me fokus pasqyrimin e nevojave të fëmijëve

Përshkrimi: Ky aktivitet nuk mbivendoset me hartimin dhe zbatimin e planit lokal social, i cili përfshin gjerësisht edhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi dhe neglizhimi. Gjithsesi, përfshirja e këtij aktiviteti synon të nxisë zbatimin e planit social me fokus fëmijët. Kështu, si pjesë e iniciativës Bashki Mike e Fëmijëve, Shërbimi Social në Bashkinë Korçë do të raportojë mbi zbatimin e planit social cdo vit, duke u fokusuar në përmbushjen e nevojave të fëmijëve/adoleshentëve më të cënueshëm. .

Afati i Zbatimit: Viti 2024-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet vjetore të monitorimit

Aktiviteti 1.2.2 Rifreskimi dhe/ose monitorimi i zbatimit të Planit lokal për arsimin parashkollor

Përshkrimi: Në bazë të ligjit 69/2018 të ndryshuar për arsimin, Bashkisë i kalon në juridiksionin e saj çdo çështje që lidhet ngushtë me mbarëvajtjen e arsimit parashkollor. Në këtë kuadër Bashkia Korçë harton planin strategjik, në kuadër të përmirësimit të shërbimit. Vizioni i planit strategjik është të sigurojë arsim gjithëpërfshirës për çdo fëmijë të territorit të Bashkisë së Korçës. Me këtë objektivi, iniciativa do të monitorojë zbatimin e planit strategjik dhe do të raportojë mbi rezultatet e sjella për fëmijët në bashkinë Korçë.

Afati i Zbatimit: Viti 2024 **Materialet e zhvilluara:** Raportet vjetore të monitorimit

Aktiviteti 1.2.3 Botimi vjetor i statistikave me fokus fëmijëve dhe adoleshentëve në Korçë

Përshkrimi: Nje botim vjetor do të përgatitet nga Bashkia Korçë, i cili përmban të gjitha statistikave demografike dhe të gjithë ato sektorë që përfaqësojnë interesat e fëmijëve dhe adoleshentëve si: arsimi, mbrojtja sociale, shëndetësia, drejtësia, etj. Këto të dhëna japin një vështrim mbi situatën që ndodhen fëmijët në bashkinë Korçë, dhe i ndihmojnë vendimmarrësit të zhvillojnë plane që kanë në fokus fëmijët. Botimi do të ndihmojë edhe rishikimin e përvitshëm të Planit Bashki Mike e Fëmijëve.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Raportet vjetore të monitorimit

Aktiviteti 1.2.4 Organizimi i takimeve gjashtëmuajore të Komitetit Drejtues të iniciativës “Bashki Mike e fëmijëve” mbi ecurinë e zbatimit të planit

Përshkrimi: Komiteti drejtues ngrihet në fillim të zbatimit të iniciativës, dhe përben organin drejtues të saj. Roli dhe përgjegjësitë e komitetit janë specifikuar në Termat e Referencës, të detajuara në seksionin 2 të këtij dokumenti. Komiteti mblidhet në fillim për të aproviar Planin e aktiviteteve, dhe në vazhdim të ciklit 3 vjeçar mblidhet për të diskutuar rreth statusit të zbatimit të tij. Anëtarët dhe përgjegjësitë e KD janë të detajuara në Seksionin 2 të këtij dokumenti.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Minutat e takimeve

Aktiviteti 1.2.5 Rifreskim vjetor i Planit të aktiviteteve të iniciativës, monitorimi dhe raportimi i zbatimi të tij në Këshillin Bashkiak

Përshkrimi: Bashkia Korçë, nëpërmjet koordinatorit të iniciativës “Bashki mike e fëmijëve” dhe në bashkëpunim me komitetin drejtues, do të udhëheqë rifreskimin vjetor të planit të aktiviteteve bazuar në monitorimin e zbatimit të aktiviteteve në vitin pararendës. Në takimet vjetore me këshillin bashkiak, përfaqësues të bashkisë/komitetit drejtues do të bejnë prezantimin e arritjeve të planit të aktiviteteve dhe gjithashtu do të shtrojnë për aprovim ndyshime apo rifreskime të mundshme.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2025 **Materialet e zhvilluara:** Progres raporte vjetore, Plani i aktiviteteve i rifreskuar

Aktiviteti 1.2.6 Promovimi dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e zbatimit të iniciativës dhe promovimi i arritjeve të saj.

Përshkrimi: Bashkia Korçë, si pjesë e strategjisë së saj të komunikimit do të promovojë iniciativën, rëndësinë e saj dhe rezultatet e arrira. Mesazhe kryesore do të shpërndahen në median sociale, median vizive dhe atë të shkruar në lidhje me objektivat kryesore të iniciativës dhe rezultatet e arrira në avancimin e të drejtave të fëmijëve në bashkinë Korçë.

Afati i Zbatimit: Viti 2023-2024 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e Progres raporteve vjetore

Aktiviteti 1.2.7 Kryerja e studimit për të matur efektshmërinë e Planit të Aktiviteteve të iniciativës

Përshkrimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me partnerët e saj vendor, do të zhvillojë termat e referencës për vlerësimin e iniciativës. Vlerësimi i zbatimit të Planit të Veprimit në fund të ciklit do të jetë i pavarur. Ai do të shërbejë për të matur progresin dhe ndikimin që ka patur iniciativa në nivel vendor. Bashkia më pas do të ndajnë gjetjet në publik për të vazhduar nismën, dhe për të vendosur objektiva të tjerë plotësues.

Afati i Zbatimit: Viti 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporti i Vlerësimit

Qëllimi 2: Çdo fëmijë dhe adoleshent është i mbrojtur, respektohet dhe trajtohet në mënyrë të drejtë në komunitetin e tij

Objekti 2.1: Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë akses më të përshtatshëm në shërbime që promovojnë përfshirjen sociale

Aktiviteti 2.1.1 Rifreskimi vjetor i hartëzimit të ambjenteve publike me fokus pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për fëmijët me aftësi ndryshe.

Përshkrimi: Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët. Duke pasur parasysh ofrimin e mundësive për t'u rritur si çdo fëmijë tjetër, ata kanë potencialin për të bërë jetë të përbashkët, dinjitoze dhe për të kontribuar në vitalitetin shoqëror, kulturor dhe ekonomik të komuniteteve të tyre. Duke u bazuar në këtë objektivi, Bashkia Korçë e ka pjesë të punës së saj dokumentimin e inventarit fizik të ndërtesave publike dhe atyre të arsimit, inventar i cili do të rifresktohet çdo vit.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.1.2 Fëmijët me aftësi të kufizuara përfitojnë nga rikonstruksioni i ambjenteve publike në funksion të tyre

Përshkrimi: Fëmijët me aftësi të kufizuara duhet të kenë akses dhe të ndihen të përfshirë. Elementet e përbashkëta të aksesit dhe përfshirjes janë heqja ose zvogëlimi i pengesave mjedisore dhe infrastrukturore për pjesëmarrjen në aktivitetet dhe funksionet e një komuniteti. Bashkia Korçë ka filluar punën më plotësimin me rampa të të gjitha godinave arsimore, në mënyrë që të eliminojë barrierat fizike të pjesëmarrjes në arsim. Brenda vitin 2024, të gjitha institucionet arsimore do të jenë pajisur me rampa.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2024 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.1.3 Dokumentimi i barrierave që hasin fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre në integrimin gjithëpërfshirës

Përshkrimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Universitetin Fan S. Noli në Korçë, do të punojnë për të dokumentuar barrierat që hasin fëmijët me aftësi të kufizuara në Korçë në shërbime dhe në jetën komunitare. Identifikimi i hershëm i barrierave ndihmon në përmirësimin e aksesit në shërbime cilësore për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe çdo paaftësi tjetër.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.1.4 Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve rreth aftësisë së kufizuara

Përshkrimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Universitetin Fan S. Noli në Korçë, dhe zyrën vendore të arsimit, do të punojnë për të organizuar aktivitete ndërgjegjësuëse në lidhje me aftësinë e kufizuara. Rritja e ndërgjegjësimit për aftësinë e kufizuara është e rëndësishme sepse u mëson njerëzve se si ajo ndikon në jetën e tyre dhe si mund të ndihmohet dikush me aftësi të kufizuara. Ndhmon gjithashtu për të ulur stereotipet që lidhen me aftësitë e kufizuara dhe për të hequr stigmën kryesisht rreth paaftësisë mendore. Aktivitetet ndërgjegjësuëse do të zhvillohen në shkollat si pjesë e aktiviteteve kurrkulare dhe extra-kurrkulare, pr edhe me komunitetet, prindërit dhe ofruesit e shërbimeve.

Afati i Zbatimit: Viti 2024 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Objekti 2.2 Fëmijët, kryesisht ata nga grupet vulnerabël kanë mundësi për t'u përfshirë në aktivitete në komunitetin e tyre

Aktiviteti 2.2.1 Organizmi i kampit veror “Miqësia” me pjesëmarrjen e fëmijëve të moshës 6-12 vjeç nga të gjitha grupet e popullatës

Përshkrimi: Bashkia Korçë u mundëson të gjithë vogelushëve nga moshë 6 – 12 vjeç, pjesëmarrjen në kampin veror “Miqësia”. Kampi zhvillohet në ambientet e Parkut "Rinia" dhe zgjat rreth 20 ditë dhe mbledh së bashku **300 fëmijë** pjesë e komuniteteve të ndryshme, si nga komuniteti Rom dhe Egjiptian, fëmijë jetimë si edhe fëmijë me aftësi ndryshe. Kampi veror është për fëmijët një mënyrë për tu argetuar dhe anagazhuar me bashkëmohatarët e tyre, njëkohësisht edhe një eksperiencë mësimore nëpërmjet aktiviteteve apo eskursioneve të ndryshme.

Kampi përfshin edhe ofrimin të ushqimit falas dhe objekti është të mbahet një raport i qëndrueshëm i grupeve pjesëmarrëse, veçanërisht të fëmijëve me aftësi ndryshe dhe atyre nga komuniteti Rom dhe Egjiptian. Bashkia Korçë është asitur nga një grup donatorësh që veprojnë në Bashkinë Korçë për të mundësuar këtë aktivitet ndër vite.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.2.2 Organizimi i kampit veror “Miqësia” për fëmijët e zonave rurale

Përshkrimi: Si pjesë e iniciativës, Bashkia Korçë angazhohet të rrisi numrin e fëmijëve që marrin pjesë në kampin veror në 3 vitet e ardhshme, duke përfshirë edhe ata nga zonat rurale të Bashkisë. Kampi veror do të zhvillohet në ambientet e shkollave të njësisë administrative, ku do të zbatohet i njëjti program.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.2.3. Qyteza e fëmijëve ofron aktivitete sportive/edukuese/argëtuese për fëmijët përfshirë ata nga komunitetet vulnerabile

Qyteza e Fëmijëve është një qendër multifunksionale për fëmijët që ofron edukimin dhe zhvillimin e tyre në fushën intelektuale, sociale, shkencore, fizike dhe artistike. Kjo qendër ofron shërbime që kultivojnë vlera dhe aftësi për jetën për fëmijët nga moshë 3-14 vjeç. Ajo vjen si një zgjidhje për zhvillimin jashtëshkollor të fëmijëve dhe të rinjve të rajonit të Korçës dhe jo vetëm, duke krijuar platforma specifike me kushte dhe facilitete bashkëkohore për të lehtësuar zhvillimin e fëmijëve. Aktualisht Qyteza ofron një seri aktivitetsh në Shkencat ekzakte, arte pamore, punë artizanale art& craft, kinema për fëmijë, aktivitete sportive, Metodologji Montessori, lojra tavoline, leximi i librave për fëmijë, aktivitete, të cilat nxisin interesin për të lexuarin, kënd lojrash për fëmijë 3-6 vjeç, facepainting, aktivitete argëtuese me familjen, kampe verore, aktivitete rutinë të kurseve të ndryshme, Ambientet e Qytezës ofrohen nga Bashkia, e cila mbulon edhe kostot e tjera operative, dhe u vjen në shërbim fëmijëve dhe të rinjve për të zhvilluar aftësitë e tyre.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Objektivit 2.3 Prindërit / kujdestarët e fëmijëve kanë akses ndaj programeve të edukimit pozitiv të fëmijëve

Aktiviteti 2.3.1 Trainimi i të gjithë specialistëve/ofruesve të shërbimit mbi programin e prindërimit pozitiv

Përshkrimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Organizata partnere ofron programe të prindërimit pozitiv në qendrat ditore të bashkisë. Këto programe i ndihmojnë prindërit të përmbushin në mënyrë proaktive nevojat emocionale të fëmijëve të tyre përmes ndërveprimeve pozitive, të cilat mund të parandalojnë shumë sjellje të këqija. Organizatat partnere ofrojnë trajnime të vazhdueshme për specialistët në lidhje me prindërimin pozitiv, një iniciative e domosdoshme.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** curricula trajnimi, progress-raportet vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.3.2 Funkionimi i programit të prindërimit në të gjitha qendrat ditore të bashkisë Korçë

Përshkrimi: Bashkia do të mbështesë vazhdimin e programeve të prindërimit pozitiv në qendrat ditore, dhe në bashkëpunim me organizatat partnere do të zgjerojë grupet e synuara.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.3.3 Aktivitete ndërgjegjësuere për prindërit dhe fëmijët për rolin e institucioneve të pavarura që mbrojnë të drejtat e fëmijëve

Përshkrimi: Institucioni i Komisionerit antidiskriminimit kryen aktivitete me shkollat dhe komunitet për ti njohur ata rreth rolit që kanë insitutionet e të drejtave të njeriut në shqipëri, si mund të ndihmojnë fëmijët, sidomos ato nga shtresat e cënueshme. Bashkia dhe ZVA e mbështet këtë iniciativë dhe ofron bashkëpunimin e saj gjatë seancave informuese.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Aktiviteti 2.3.4 Aktivitete ndërgjegjësuere me fëmijët dhe prindërit në lidhje me sjelljet pozitive

Përshkrimi: ZVA e monitoron termën e sjelljeve positive që kryehennë shkolla si pjesë e orëve të kujdestarisë apo orëve ekstrakurrikulare. Ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe komuniteteve rreth sjelljeve positive mbetet një prioritet i bashkisë Korçë, e cila në bashkëpunim me Organizata partnere do të forcojë dhënien e mesazheve kryesore, dhe do të zgjerojë aktivitetet informuese.

Afati i Zbatimit: Viti 2024 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Qëllimi 3: Çdo fëmijë jeton në mjedis të sigurtë, dhe të pastër

Objektivi 3.1 Çdo fëmijë lëviz i sigurtë dhe i pavarur

Aktiviteti 3.1.1 Aktivitete edukuese në shkolla për sinjalistikën e sigurtë

Përshkrimi: Aktivitetet edukuese për sinjalistikën janë pjesë e kurrikulës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara me aktivitete ekstrakurrikulare, të organizuara nga shkollat. Bashkia në bashkëpunim me ZVA do të monitorojë informacionin dhe grupet e fëmijëve të synuar për marrjen e këtij informacioni, shoqëruar me punimet në infrastrukturë (korsitë e biçikletave) të cilat kanë përfunduar. Kjo do të forcojë përdorimin e biçikletave më shumë nga fëmijët dhe te rinjtë.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** pjesë e progress-raporteve vjetore të iniciativës.

Objektivi 3.2 Çdo fëmijë lundron i sigurtë në internet

Aktiviteti 3.2.1 Vendosja e friendly Ēifi në ambjente publike

Përshkrimi: Bashkia e Korçës, si pjesë e mbrojtjes së fëmijëve ka edhe mbrojtjen nga rreziku I internetit. Si hap I parë Bashkia do të sigurojë vendosjen e internetit miqësor në 2 ambjete publike të bashkisë. Interneti miqësor ka disa filtra të cilët garantojnë që fëmijët dhe të rinjtë të mos rrezikohen të shikojnë dhe të kenë akses në materiale të papërshtatshme për ta.

Afati i Zbatimit: Viti 2024 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** kontrata me ofrues të internetit

Aktiviteti 3.2.2 Fëmijët dhe prindërit informohen rreth rrezikut në internet dhe lundrimit të sigurtë

Përshkrimi: Aktivitetet edukuese për lundrimin në internet janë pjesë e kurrikulës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara me aktivitete ekstrakurrikulare, të organizuara nga mësuesit t informatikës. ASKAP ka zhvilluar gjithashtu manual që të orientojnë rreth mesazheve kryesore që u duhen dhënë fëmijëve. Bashkia në bashkëpunim me Organizata partnere do të zgjerojë aktivitetet informuese me prindërit dhe komunitetet.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Objektivi 3.3 Çdo fëmijë jeton në mjedis të pastër/gjelbëruar

Aktiviteti 3.3.1 Parqet dhe hapësirat e tjera publike gjelbërohen dhe mirëmbahen për të përmirësuar cilësinë e ajrit

Përshkrimi: Bashkia Korçë, si pjesë e planit të saj urbanistik, ka në qendër edhe gjelbërimin. Planet vjetore të gjelbërimit përfshijnë mirëmbajtjen e lulishteve dhe ndërtimin e të rejave.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Progres raporti vjetor

Aktiviteti 3.3.2 Parqet e qytetit kanë sinjalistikën përkatëse

Përshkrimi: Bashkia Korçë, zhvillon plane vjetore të mirëmbajtjes së sinjalistikës dhe vendosjes së sinjalistikës së re kur është e nevojshme. Këto ambiente u sigurojnë fëmijëve ambiente të pastra dhe të sigurta.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Progres raporti vjetor

Aktiviteti 3.3.3 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar ambientet e gjelbërta dhe përdorimin e sinjalistikës

Përshkrimi: Aktivitetet edukuese për lundrimin në internet janë pjesë e kurrikulës dhe jepen si orë mësimore, të kombinuara me aktivitete ekstrakurrikulare, të organizuara nga mësuesit t informatikës. ASKAP ka zhvilluar gjithashtu manual që të orientojnë rreth mesazheve kryesore që u duhen dhënë fëmijëve. Bashkia në bashkëpunim me Organizata partnere do të zgjerojë aktivitetet informuese me prindërit dhe komunitetet.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Aktiviteti 3.3.4 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimit të mbetjeve urbane

Përshkrimi: Aktivitetet edukuese/jshtë shkollore organizohen nga Bashkia, në bashkëpunim me Organizata partnere. Këto aktivitete informojnë fëmijët për të mbajtur ambientin pastër. Aktivitetete do të zgjerohen edhe për prindërit dhe komunitetet.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Qëllimi 4: Çdo fëmijë dhe i ri ka mundësi të shijojë lojën, kohën e lirë dhe të zhvillojë aftësitë për jetën

Objektivi 4.1: Hapësira të aksesueshme dhe sigurta për lojën dhe kohën e lirë

Aktiviteti 4.1.1 (Ri) Certifikimi vjetor i të paktën 10 restoranteve dhe hoteleve miqësore për fëmijët/adoleshentët (rishikimi i standardeve të certifikimit)

Përshkrimi: Metodologjia përshkruhet në seksionin 4 të këtij dokumenti.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Aktiviteti 4.1.2. Funksionimi i qendrave sportive dhe kulturore sipas standardeve për garantimin e sigurisë ndaj fëmijëve, dhe trajnimi i stafit

Përshkrimi: Bashkia Korçë në bashkëpunim me Organizata partnere do të mundësojë aktivitete informuese dhe aftësuese për ofruesit e shërbimeve rreth standardeve për mbrojtjen e fëmijëve. Këto programe do të sigurojnë që fëmijët që marrin pjesë në aktivitete kulturore dhe sportive të ofruara nga qendrat e bashkisë, por jo vetëm, shërbehen nga profesionitë të aftë dhe mbrohen nga rreziqet e abuzimit, dhunës dhe të tjera.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Aktiviteti 4.1.3 Hartimi i planit të ndërtimit të këndeve të lojrave për çdo lagje për moshën 0-6 vjeç

Përshkrimi: Plani i ndërtimeve të këndeve të lojrave është pjesë a planit të zhvillimit urban të bashkisë. Si pjesë e iniciativës, do të monitorohet hartimi dhe zbatimi i planit për të garantuar ambjente për lojën dhe kohën e lirë për fëmijët e Korçës, dhe grupet e cënueshmë në veçanti.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Aktiviteti 4.1.4 Ndërtimi/rinovimi i këndeve të lojrave dhe ambjenteve të tjera rikrjuese të përshtatura për akses nga fëmijët me aftësi të kufizuar

Përshkrimi: Plani i ndërtimeve të këndeve të lojrave është pjesë a planit të zhvillimit urban të bashkisë. Si pjesë e iniciativës, do të monitorohet hartimi dhe zbatimi i planit për të garantuar ambjente për lojën dhe kohën e lirë për fëmijët e Korçës, dhe grupet e cënueshmë në veçanti.

Afati i Zbatimit: Viti 2024 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Objektivi 4.2 Çdo fëmijë ka mundësi të barabarta për aftësim

Aktiviteti 4.2.1 Zhvillimi i akademisë ICT për të rritur njohuritë dhe aftësitë në programim

Përshkrimi: Bashkia Korçë, organizoi për hetrë të parë në vitin 2022 Akademinë më të madhë të inovacionit: “Korça ICT Academy-Code for Albania”. Në këtë akademi verore, morën pjesë, 150 të rinj nga e gjithë Shqipëria, 30% prej tyre ishin nga Korça. Akademia do të vijojë përgjatë vitit me sesione mësimore online çdo javë, në mënyrë që të rinjtë të mund të zhvillojnë më tej aftësitë e të menduarit, të programimit dhe të projektimit, duke hedhur kështu një hap të sigurt për ardhmen e tyre.

Ky aktivitet do ti mbështesë këta të rinj për gjatë 3 viteve të ardhshme, në mënyrë që ty ofrojë një cikël të ploitë aftësimi. Bashkia sëmbashku me partnerët e saj, do të mbështesë këtë program si pjesë e strategjisë “Korça qytet inteligjent”.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2024 **Materialet e zhvilluara:** Raporte të aktiviteteve.

Aktivitet 4.2.2 Përshtatja e Infrastrukturës së qendrës së fëmijëve në qendër digitale.

Përshkrimi: Bashkia si pjesë e strategjisë “Korça qytet inteligjent” do të ofrojë mundësinë e zhvillimit të aftësive teknologjike edhe për fëmijët e moshës 7-15 vjeç. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me Organizata partnere do të investojë në krijimin e bibliotekës dixhitale për fëmijë.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 **Materialet e zhvilluara:** Progres Raporti I iniciativës

Aktiviteti 4.2.3 Fëmijët dhe adoleshentët janë trainuar në aftësitë e jetës, sipërmarrjes sociale, kuptimin dhe përdorimin të medias, punësimin, dhe programe orientuese të karrierës

Përshkrimi: Bashkia në bashkëpunim me organizatat partnere që punojnë në fushën e zhvillimit në Korçë, mundëson dhe monitoron ofrimin e programeve në lidhje me aftësimin e të rinjve për jetën, karrierën, sipërmarrjen apo përdorimin e medias. Të gjitha këto programe organizohen për të gjitha grupet e fëmijëve, por synojnë edhe përfshirjen e grupeve të cënueshme, dhe ofrohen nga qendrat ditore, multifunkionale apo Qyteza e Fëmijëve. Ky është një investim i rëndësishëm i Bashkisë, dhe që do të monitorohet si pjesë e iniciativës “BAshki Mike e fëmijëve” për të informuar rreth rezultateve. Edhe sektori i arsimit mundëson disa shkolla që nëpërmjet kurrikulës më zgjedhje, të zgjedhin orientimin e karrierës, si pjesë e aftësive për jetën.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Progres Raporti i iniciativës

Aktiviteti 4.2.4 Fëmijët kanë akses në këndet digitale për të zhvilluar njohuritë e tyre në fushën e ICTs

Përshkrimi: Bashkia Korçë sëmbashku me organizatat partnere, punon jo vetëm për të ngritur infrastrukturën e mundur për aftësimin e fëmijëve dhe të rinjve, por mundëson gjithëpërfshirjen në këto programe. Nëpërmjet iniciativës “Bashki Mike e Fëmijëve” do të monitorohet pjesëmarrja e fëmijëve në këto programe, dhe specifikisht pjesëmarrja e grupeve të cënueshme.

Afati i Zbatimit: Viti 2023 - 2025 **Materialet e zhvilluara:** Progres Raporti i iniciativës

SEKSIONI 1 -PLANI I VEPRIMIT

Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	
Qëllimi 1: Çdo fëmijë dhe adoleshent ka mundësi për të kontribuar në proceset vendim-marrëse që ndikojnë tek ta.	% e rekomandimeve nga fëmijët të marra në konsideratë për të përmirësuar Planet dhe buxhetin e bashkisë	0	20 % në vit	Bashkia Korçë	Vjetore	
Objektivi 1.1 Fëmijët kanë mundësitë dhe platformat për të influencuar vendimet që ndikojnë tek ta.	Numri i mbledhjeve të këshillit bashkiak që adreson çështjet e ngritura nga KKF Numri i anketave të kryera nëpërmjet U-Report	0 0	3 mbledhje (1 çdo vit) 3 anketa (1 çdo vit)	Bashkia Korçë UNICEF	Vjetore	
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 1.1.1 Këshilli konsultativ i fëmijëve (KKF)përcaktohet/rinovohet çdo vit	Bashkia Korçë; ZVA; Donatorë	825,648.00	275,216.00	275,216.00	275,216.00	450,000.00
Aktiviteti 1.1.2 Takime vjetore të Këshillt konsultativ të fëmijëve më	Bashkia Korçë; ZVA; Donatore	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	150,000.00

aktorët kryesorë në nivel lokal						
Aktiviteti 1.1.3 Organizimi i dy takimeve (vjetore) për të mbledhur opinionet e gjera të fëmijëve (boot camps) për të ndikuar në buxhetin vjetor të bashkisë	Bashkia Korçë; ZVA; Donatorë	375,648.00	125,216.00	125,216.00	125,216.00	0.00
Aktiviteti 1.1.4 Organizimi i aktiviteteve për të promovuar dhe angazhuar U reporting.	Bashkia Korçë; ZVA; Donatorë	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	150,000.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit		Frekuenca në raportim
Objektivi 1.2 Fëmijët dhe adoleshentët përfitojnë nga politika vendore të orientuara nga nevojat e tyre	% e masave të planeve lokale të realizuara	0	80%	Bashkia Korçë		Raporte vjetore të monitorimit të planit
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 1.2.1 Monitorimi i zbatimit të Planit lokal social, me fokus pasqyrimin e nevojave të fëmijeve	Bashkia Korçë; Donatorë	125,216.00	0	62,608.00	62,608.00	0.00

<u>Aktiviteti 1.2.2</u> Rifreskimi dhe/ose monitorimi i zbatimit të Planit lokal për arsimin parashkollor	Bashkia Korçë;	187,824.00	0	187,824.00	0	0.00
<u>Aktiviteti 1.2.3</u> Botimi vjetor i statistikave me fokus fëmijëve dhe adoleshentëve në Korçë	Bashkia Korçë; Donatorë	1,088,472.00	362,824.00	362,824.00	362,824.00	525,000.00
<u>Aktiviteti 1.2.4</u> Organizimi i takimeve gjashtëmujore të Komitetit Drejtues të iniciativës “Bashki Mike e fëmijëve” mbi ecurinë e zbatimit të planit	Bashkia Korçë; Donatorë	287,824.00	112,608.00	112,608.00	62,608.00	100,000.00
<u>Aktiviteti 1.2.5</u> Rifreskim vjetor i Planit të Punës të iniciativës, monitorimi dhe raportimi i zbatimi të tij në Këshillin Bashkiak	Komiteti Drejtues i iniciativës “Bashkia Mike e Fëmijëve”, Donatorë	637,824.00	212,608.00	212,608.00	212,608.00	450,000.00
<u>Aktiviteti 1.2.6</u> Promovimi dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e zbatimit të Iniciativës dhe promovimi i arritjeve të saj	Bashkia Korçë;	225,216.00	112,608.00	112,608.00	0	100,000.00
<u>Aktiviteti 1.2.7</u> Kryerja e studimit për të matur efektshmërinë e Planit të Aktiviteteve të iniciativës	Bashkia Korçë; Universiteti Fan S. Noli, Donatorë	325,608.00	0	0	325,608.00	150,000.00

Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	
Qëllimi 2: Çdo fëmijë dhe adoleshent është i mbrojtur, respektohet dhe trajtohet në mënyrë të drejtë në komunitetin e tij	(%) Rritja e perceptimit pozitiv të prindërve dhe fëmijëve në lidhje me rritjen e mundësive gjithëpërfshirëse të fëmijeve	0	10% rritje në perceptime pozitive çdo vit	Bashkia Korçë	Vjetore	
Objektivi 2.1: Fëmijët me aftësi të kufizuar kanë akses më të përshtatshëm në shërbime që promovojnë përfshirjen sociale	Numri i ambjenteve publike që janë rinovuar për të shmangur pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për fëmijët me aftësi të kufizuar	0	3	Bashkia Korçë	Vjetore	
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 2.1.1 Rifreskimi vjetor i hartëzimit të ambjenteve publike me fokus pengesat mjedisore dhe infrastrukturore për fëmijët me aftësi ndryshe.	Bashkia Korçë	1,502,592.00	500,864.00	500,864.00	500,864.00	0.00
Aktiviteti 2.1.2 Fëmijët me aftësi të kufizuar përfitojnë nga rikonstruksioni i ambjenteve publike në funksion të tyre	Bashkia Korçë; Donatorë	2,800,000.00	1,400,000.00	1,400,000.00	0	0.00

<u>Aktiviteti 2.1.3</u> Dokumentimi i barrierave që hasin fëmijët me aftësi të kufizuar dhe prindërit e tyre në integrimin gjithëpërfshirës	Bashkia Korçë; ZVA, Universiteti “Fan S. Noli”, Donatorë	325,608.00	325,608.00	0	0	263,000.00
<u>Aktiviteti 2.1.4</u> Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve rreth aftësisë së kufizuar	Bashkia Korçë; ZVA, Universiteti “Fan S. Noli”, Donatorë	576,432.00	0	288,216.00	288,216.00	100,000.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit		Frekuenca në raportim
Objektivi 2.2 Fëmijët, kryesisht ata nga grupet vulnerabël kanë mundësi për t’u përfshirë në aktivitete në komunitetin e tyre	Numri i fëmijëve nga grupet e cënueshme që marrin pjesë në programe gjithëpërfshirëse argëtuese/edukative	200 fëmijë cdo vere	300 cdo vit (20% Fëmijë me aftësi të kufizuar, 50% Roma/Egjiptian)	Bashkia Korçë		Vjetore
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 2.2.1 Organizmi i kampit veror “Miqësia” me pjesëmarrjen e fëmijëve të moshës 6-12 vjeç nga të gjitha grupet e popullatës	Bashkia Korçë	1,500,000.00	500,000.00	500,000.00	500,000.00	750,000.00

<u>Aktiviteti 2.2.2</u> Organizimi i kampit veror “Miqësia” për fëmijët e zonave rurale	Bashkia Korçë dhe Donatorë	975,378.00	325,126.00	325,126.00	325,126.00	600,000.00
<u>Aktiviteti 2.2.3.</u> Qyteza e fëmijëve ofron aktivitete sportive/edukuese/argëtuese për fëmijët përfshirë ata nga komunitetet vulnerable	Bashkia Korçë dhe Donatorë	238,680,000.00	79,560,000.00	79,560,000.00	79,560,000.00	14,400,000.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit		Frekuenca në raportim
<u>Objektivit 2.3</u> Prindërit / kujdestarët e fëmijëve kanë akses ndaj programeve të edukimit pozitiv të fëmijëve	Numri i qendrave ditore që kanë funksionale Programin e Prindërimit pozitiv	0	3	Bashkia Korçë TBD		Vjetore
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2026	Mungesa në Financim
<u>Aktiviteti 2.3.1</u> Trainimi i të gjithë specialistëve/ofruesve të shërbimit mbi programin e prindërimit pozitiv	Bashkia Korçë dhe Donatorë	367,824.00	122,608.00	122,608.00	122,608.00	180,000.00
<u>Aktiviteti 2.3.2</u> Funksionimi i programit të prindërimit në të gjitha qendrat ditore të bashkisë Korçë	Bashkia Korçë dhe Donatorë	1,326,867.00	442,289.00	442,289.00	442,289.00	884,578.00
<u>Aktiviteti 2.3.3</u> Aktivitete ndërgjegjësuere për prindërit	Bashkia Korçë;	543,912.00	181,304.00	181,304.00	181,304.00	90,000.00

dhe fëmijët për rolin e institucioneve të pavarura që mbrojnë të drejtat e fëmijëve	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, donatorë					
Aktiviteti 2.3.4 Aktivitete ndërgjegjësuese me fëmijët dhe prindërit në lidhje me sjelljet pozitive	Bashkia Korçë; Donatorë	250,432.00	0	125,216.00	125,216.00	0.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	
Qëllimi 3: Çdo fëmijë jeton në mjedis të sigurtë, dhe të pastër	(%) Rritja e përceptimeve pozitive femije dhe adoleshente për mjediset ku jetojnë	0	10% rritje çdo vit	Bashkia Korçë	Vjetore	
Objektivi 3.1 Çdo fëmijë lëviz i sigurtë dhe i pavarur	Numri i fëmijëve të informuar rreth masave për levizjen e tyre të sigurtë	Per tu percaktuar	Per tu percaktuar	Bashkia Korçë	Vjetore	
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 3.1.1 Aktivitete edukuese në shkolla për sinjalistikën e sigurtë	Bashkia Korçë; ZVA	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	0.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	

Objektivi 3.2 Çdo fëmijë lundron i sigurtë në internet	Numri i ambjeteve publike më Frindly Wifi	0	2	Bashkia Korçë	Vjetore	
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 3.2.1 Vendosja e friendly Wifi në ambjete publike	Bashkia Korçë; Donatorë	1,525,216.00	0	762,608.00	762,608.00	1,400,000.00
Aktiviteti 3.2.2 Fëmijët dhe prindërit informohen rreth rrezikut në internet dhe lundrimit të sigurtë	Bashkia Korçë; ZVA dhe Donatorë	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	150,000.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	
Objektivi 3.3 Çdo fëmijë jeton në mjedis të pastër/gjelbëruar	Shtrirja e hapësirave të gjelbërta (në m ²)	Ska reference	Shtuar me 10 000 m ²	Bashkia Korçë	Vjetore	
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 3.3.1 Parqet dhe hapësirat e tjera publike gjelbërohen dhe mirëmbahen për të përmirësuar cilësinë e ajrit	Bashkia Korçë	2,700,000.00	900,000.00	900,000.00	900,000.00	0.00

Aktiviteti 3.3.2 Parqet e qytetit kanë sinjalistikën përkatëse	Bashkia Korçë	150,000.00	50,000.00	50,000.00	50,000.00	0.00
Aktiviteti 3.3.3 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar ambientet e gjelbërta dhe përdorimin e sinjalistikës	Bashkia Korçë; ZVA; Donatorë	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	150,000.00
Aktiviteti 3.3.4 Aktivitete jashtëshkollore organizohen për të promovuar riciklimin dhe ripërdorimit të mbetjeve urbane	Bashkia Korçë; ZVA; Donatorë	525,648.00	175,216.00	175,216.00	175,216.00	150,000.00
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit	Frekuenca në raportim	
Qëllimi 4: Çdo fëmijë dhe i ri ka mundësi të shijojë lojën, kohën e lirë dhe të zhvillojë aftësitë për jetën	(%) Përceptimeve pozitive të fëmijëve dhe të adoleshente lidhur me cilësinë e kalimit të kohës së lirë (%) Përceptimeve pozitive të fëmijëve dhe të rinjve lidhur me mundësitë për realizimin e aftësive për jetën	0	10% çdo vit 10% çdo vit	Bashkia Korçë	Vjetore	
Objektivi 4.1: Hapësira të aksesueshme dhe sigurta për lojën dhe kohën e lirë	Numi i hapësirave publike që ofrojnë hapësira të	0	5	Bashkia Korçë	Vjetore	

	aksesuesme për të gjithë fëmijët					
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
<u>Aktiviteti 4.1.1</u> (Ri) Certifikimi vjetor i të paktën 10 restoranteve dhe hoteleve miqësore për fëmijët/adoleshentët (rishikimi i standardeve të certifikimit)	Bashkia Korçë dhe Donatorë	742,824.00	297,608.00	222,608.00	222,608.00	75,000.00
<u>Aktiviteti 4.1.2.</u> Funksionimi i qendrave sportive dhe kulturore sipas standardeve për garantimin e sigurisë ndaj fëmijëve, dhe trajnimi i stafit	Bashkia Korçë dhe Donatorë	387,824.00	62,608.00	162,608.00	162,608.00	100,000.00
<u>Aktiviteti 4.1.3</u> Hartimi i planit të ndërtimit të këndeve të lojrave për çdo lagje për moshën 0-6 vjeç	Bashkia Korçë dhe Donatorë	375,648.00	125,216.00	125,216.00	125,216.00	0.00
<u>Aktiviteti 4.1.4</u> Ndërtimi/rinovimi i këndeve të lojrave dhe ambjenteve të tjera rikrjuese të përshtatura	Bashkia Korçë dhe Donatorë	4,125,216.00		2,062,608.00	2,062,608.00	0.00

për akses nga fëmijët me aftësi të kufizuar						
Objektiv/Qëllimi	Treguesi	Baza	Targeti	Burimi i informacionit		Frekuenca në raportim
Objektivi 4.2 Çdo fëmijë ka mundësi të barabarta për aftësim	Numri i fëmijëve me aftësi të zhvilluara ne ICT	0	360 femije	Korça Municipality		Annual
Aktivitetet	Personi përgjegjës	Kosto e vlerësuar e të gjithë aktivitetit	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2023	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2024	Burimi dhe shuma e financuar për vitin 2025	Mungesa në Financim
Aktiviteti 4.2.1 Zhvillimi i akademisë ICT për të rritur njohuritë dhe aftësitë në programim (150 femije ne total)	Bashkia Korçë, Donatoret	16,000,000.00	8,000,000.00	8,000,000.00	0	16,000,000.00
Aktivitet 4.2.2 Përshtatja e Infrastrukturës se qendrës se fëmijëve në qendër digitale.	Bashkia Korçë, Donatoret	4,387,824.00	1,462,608.00	62,608.00	62,608.00	1,400,000.00
Aktiviteti 4.2.3 Fëmijët dhe adoleshentët janë trainuar në aftësitë e jetës, sipërmarrjes sociale, kuptimin dhe përdorimin të medias, punësimit, dhe programe orientuese të karrierës	Bashkia Korçë; ZVA dhe Donatorë	270,000.00	90,000.00	90,000.00	90,000.00	180,000.00

<u>Aktiviteti 4.2.4</u> Fëmijët kanë akses në këndet digitale për të zhvilluar njohuritë e tyre në fushën e ICTs	Bashkia Korçë dhe Donatorë	307,824.00	102,608.00	102,608.00	102,608.00	120,000.00
---	----------------------------	------------	------------	------------	------------	------------

SEKSIONI 2 – KOMITETI DREJTUES

Bashkia Korçë është bërë pjesë e iniciativës “Bashki mike e fëmijëve”. Kjo iniciativë i jep mundësinë bashkisë së interesuar të angazhohet në përmirësimin e jetës së fëmijëve në juridiksionin e tyre duke realizuar të drejtat e tyre të artikuluar në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) dhe më konkretisht fokusuar në:

- interesat më të mira të fëmijës;
- mos diskriminimin;
- zbatimin e të drejtave të fëmijës,
- fuqizimin e kapaciteteve të fëmijës,
- të drejtën për mbijetesë dhe zhvillim të jetës,
- respektimin e pikëpamjeve dhe zërit të fëmijës.

Pjese e integrale e iniciativës është edhe Komiteti Drejtues (KD), me përfaqësues të sektorëve dhe institucioneve vendore, si dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm vendor.

Qëllimi i komitetit drejtues KD

KD do të ofroje udhëzime dhe drejtime të përgjithshme mbi procesin e hartimit dhe zbatimin të iniciativës. Rol i KD-së është këshillues / propozues (jo vendimmarrës) dhe në funksion të ciklit të iniciativës. Anëtarësimi në KD mund të rinovohet me anëtarë të rinj çdo vit, sipas programeve të parashikuara.

Komiteti drejtues do të angazhohet në :

- Hartimin e Planit të Veprimit dhe buxhetit vendor të iniciativës;
- Dhënies së propozimeve lidhur me masat e përfshira në planin e veprimit;
- Konsultimit të planit me struktura/departamente të tjera relevante brenda institucionet përfaqësuese
- Monitorimit të progresit të zbatimit të planit.

Përgjegjësitë specifike të Komitetit Drejtues (KD) janë përmbledhur më poshtë:

- Vendos rreth drejtimit strategjik të ndërhyrjes, duke marrë për baze analizën e situatës së fëmijëve/adoleshentëve në Bashkinë Korçë, planeve sektoriale kombëtare dhe vendore, dhe konsultimeve me fëmijët/adoleshentët, etj.
- Jep propozimeve konkrete lidhur me masat e përfshira në planin e veprimit.
- Dakordëson për planin 3 vjeçar të masave, buxhetit dhe treguesit e performancës, para se të miratohet nga Kryetari i Bashkisë dhe këshilli bashkiak.
- Lehtëson dhe koordinon me institucione përfaqësuese zbatimin e masave.
- Udhëzon dhe dakordëson rreth masave alternative për të adresuar rreziqet e mundshme gjatë zbatimit të planit të punës.
- Në fillim të çdo viti, shqyrton raportin monitorues të ecurisë së aktiviteteve, burimet dhe ofrimin e udhëzimeve dhe bën propozimet e nevojshme për t'u adresuar.

- Promovon iniciativën në Bashkinë Korçë.
- Rishikon dhe miraton rezultatet përfundimtare (3 vjeçare) të Iniciativës;

Përfaqësimi i Komitetit Drejtues është si më poshtë: (nominal dhe një alternativ)

- Dy nënkryetarët e Bashkisë Korçë;
- Koordinatori i iniciativës (roli i sekretariatit)
- Përfaqësues nga Sektori i Arsimit;
- Përfaqësues nga Sektori i Shëndetësisë;
- Përfaqësues nga Organizatat e Shoqërisë Civile
- Përfaqësues nga Akademia/Universiteti (Departamenti i Edukimit dhe Psikologjisë së Zhvillimit)
- Sektori Privat
- Media
- Të tjerë që propozohen nga komiteti.

Kryesimi i Komitetit Drejtues caktohet nga Kryetari i Bashkisë Korçë (kryesor, plus një alternativ/zëvendës).

Pjesëmarrja dhe takimet

- Pjesëmarrja në komitet është vullnetare, e lidhur me pozicionin që anëtarët përfaqësojnë në institucion.
- Komiteti do të takohet periodikisht (2 herë në vit), dhe thirret nga Kryetari i Bashkisë për t'u informuar mbi ecurinë e iniciativës dhe të diskutojë rreth rezultateve kryesore përkatëse.
- Procesi i vendim-marrjes (i ndërmarrë nëse dhe sipas nevojës) do të zbatohet duke pasur një kuorum prej 50% anëtarësh dakord. Përditësimet shitesë dhe çështje të tjera për konsensusin e KD do të ndiqen nëpërmjet komunikimit me postën elektronike nga koordinatori i iniciativës.

Në bashkinë Korçë Komiteti përbeht nga:

Benila Terova	Nën Kryetare e bashkisë Korçë
Kletion Kita	Nën Kryetar i bashkisë Korçë
Viola Cekani	Dorcas Albania
Mariana Jorgji	Drejtorja e Kujdesit Social Bashkia Korce
Daniela Drabo	Dialogu Social
Mariela Baraku	Fondacioni Emanuel
Mikel Llogori	NJVKSH Korce
Oltian Drabo	world Vision Albania
Anjeza Vila	Fakulteti i Edukimit
Eftjola Fili	RTSH Korce
Eva Tare	Komisioneri Anti Diskriminimi
Rudina Lako	Bashkia Korce
Anila Bitraku	ZVA Korce

SEKSIONI 3 – KËSHILLI KONSULTATIV I FËMIJËVE (KKF)

Një bashki mike e fëmijëve/adoleshentëve mbështetet në pjesëmarrjen e fëmijëve dhe adoleshentëve në vendimet që i prekin ata dhe siguron funksionimin e platformave dhe mekanizmave që janë gjithëpërfshirëse për të marrë pjesë dhe për të shprehur çështjet e shqetësimeve të tyre. Të rriturit janë përgjegjës për të krijuar mjedisin që fëmijët dhe adoleshentët të ushtrojnë të drejtën e tyre të pjesëmarrjes/angazhimit.

Këshilli konsultativ ofron një mekanizëm formal për të nxitur dhe zbatuar pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrjen e qeverisjes vendore. Si përfaqësues i fëmijëve dhe adoleshentëve (zëri), Këshilli mund të përdoret si një nismë miqësore me fëmijët, duke hartuar politika pjesëmarrëse dhe përfshirjen qytetare të fëmijëve dhe të rinjve në komunitetet ku ata jetojnë.

Deri më tani, të fëmijët e pyetur në bashkinë Korçë, thonë se grupet ekzistuese të të rinjve në qytet, qofshin në bashki apo në bashki, funksionojnë të pavarur nga njëri-tjetri dhe nuk kanë bashkëpunim me qeveritë e nxënësve. Në përgjithësi, aktivitetet e tyre janë tërheqëse, informuese dhe në raste të rralla priren të kenë karakter advokues për çështje të ndryshme në Bashki. Mungojnë kapacitetet e ndjekjes së prioriteve dhe të hartimit të planeve konkrete.

Bashkia e Korçës është përgjegjëse për sigurimin e pjesëmarrjes së fëmijëve/të rinjve në këtë këshill. Bashkia duhet të sigurojë që kjo pjesëmarrje dhe çdo aktivitet që lidhet me të janë në përputhje me standartet e përgjithshme të pjesëmarrjes së fëmijëve që dalin nga zbatimi i nenit 39 të Konventës për të drejtat e fëmijes dhe të tjera dokumente ndërkombëtare.

Përbërja e Këshillit:

Bashkia Korçë në bashkëpunim me Zyrën Vendore Arsimore (ZVA) do të koordinojnë procesin e përzgjedhjes/rinovimit në fillim të çdo viti akademik të këshillit. Këshilli do të përbëhet nga:

- Një përfaqësues nga **organet e qeverisjes së çdo shkolle** (mekanizmat egzistues) në bashkinë e Korçës (gjithsej 38 shkolla). Këshilli duhet të përbëhet nga përfaqësues të qeverive të nxënësve në nivel presidencia, nënkryetar ose senator, sipas mënyrës individuale të përcaktimit të përfaqësimit të secilës shkolle.
- 5 fëmijë të tjerë nga grupe/organizata të tjera të fëmijëve/adoleshentëve (p.sh. grupi i të rinjve i mbështetur nga world Vision.)

Megjithatë, për të arritur pjesëmarrjen efektive në këshillin konsultativ të Bashkisë Korçë, ZVA si lehtësues i procesit duhet të marrë parasysh faktorët kryesorë si më poshtë:

- Përfshirja e Fëmijëve
- Stabiliteti i Grupit
- Procesi cilësor dhe kuptimplotë pjesëmarrës

Hapat kryesorë të funksionimit të Këshillit

- **Ngritja e Këshillit:** në fillim të çdo viti akademik (shtator) fëmijët e përzgjedhur, që përfaqësojnë të gjitha shkollat e bashkisë, krijojnë Këshillin Konsultativ të Fëmijëve të Korçës. Këshilli zgjedh organin drejtues dhe zgjedh komitetet që do të mbulojnë fushat kryesore me interes për fëmijët: kohën e lirë, sportet, artet, etj. Do të hartohet dhe miratohet një plan vjetor i aktiviteteve të KKF-së.

- **Njohje nga Kryetari i Bashkisë:** Këshilli njihet zyrtarisht si organ konsultativ i Këshillit të Bashkisë Korçë.
- **Aktivitetet e Ngritjes së Kapaciteteve.** Përfaqësuesit e këshillit do të marrin pjesë në një sërë aktivitetesh për ngritjen e kapaciteteve të koordinuara nga koordinatori i iniciativës për të mësuar më shumë rreth llojit të aktivitetit që ata duhet të kontribuojnë (konsultim, planifikim, vlerësim / monitorim) për të ditur qëllimin, si do të jetë procesi, kush e drejton procesin, çfarë pritet prej tyre, hapësirën kohore që duhet të vejnë në dispozicion dhe si do të përdoren mendimet dhe kontributet e tyre.
- **Mbledhja e opinioneve të fëmijëve në Bashkinë Korçë.** KFK në koordinim me koordinatorin e iniciativës do të organizojë një sërë aktivitetesh për të mbledhur zërin e bashkëmoshatarëve të tyre, për t'i përfshirë në listën e prioriteteve. Metodologjia e këtyre aktiviteteve do të finalizohet me organizatat partnere.
- **Zhvillimi i listës së prioriteteve.** Në fund të vitit akademik, KKF do të prodhojë një dokument përfundimtar që përmbledh përpjekjet e tyre për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në politik-bërje. Një listë prioritetesh do të finalizohet, me qëllimi për tu diskutuar në seancën dëgjimore publike të radhës.
- **Pjesëmarrja në diskutimin e buxhetit të Këshillit Bashkiak:** në bashkërendim me Këshillin Bashkiak, përfaqësues të KFK-së marrin pjesë në diskutimin publik të vitit buxhetor. Si pjesë e aktiviteteve aftësuese, KKF do të ketë përgatitur paraprakisht një listë prioritare për të diskutuar në seancë.
- **Koordinimi me nisma të tjera.** Pjesë e axhendës së KFK-së do të jetë edhe pjesëmarrja/kryerja e disa takimeve me nisma të tjera në vazhdim në Bashkinë e Korçës, ku zëri i fëmijëve është prioritet dhe ku mësimet e nxjerra dhe praktikat më të mira mund të përdoren dhe të përsëriten.

SEKSIONI 4 – HOTELET DHE RESTORANTET MIQESORE ME FEMIJET



RESTORANT MIK I FËMIJËVE

BASHKIA KORÇË

Koncepti

Ky aktivitet ka për qëllim krijimin e një ambienti të përshtatshëm për fëmijët në restorantet e ndryshme të qytetit. Fëmijët do të gjejnë një vend për ta i cili krijon hapësirën dhe ka materialet e duhura për t'iu përshtatur nevojave të tyre për çlodhje, argëtim, kuriozitet dhe liri.

Restorantet shpesh përdoren si vende për festimin e ditëlindjeve ose mbledhje të tjera familjare. Fëmijët janë një fuqi e mundshme shpenzuese, shpesh e nënvlerësuar. Në të njëjtën kohë, restorantet tona nuk përdoren për t'u ofruar atyre një shërbim të duhur dhe rrallëherë marrin parasysh të drejtat e tyre për një mjedis të dedikuar me mjetet e duhura.

Ky aktivitet synon t'u ofrojë fëmijëve një kohë dhe atmosferë të mirë gjatë drekës, darkës, apo festimeve të kaluara në restorantet e qytetit.

Si të bëheni një restorant miqësor për fëmijët në Korçë?

Restoranti i gatshëm për t'u njohur si "Mik i fëmijëve" duhet të ketë të paktë 3 nga standardet e përcaktuara nga Bashkia, dhe të përmendura më poshtë.

Një komision, i emëruar nga Bashkia dhe i përberë nga 3 profesionistë, do të vizitojnë restorantin dhe do të analizojë ambientet e tij. Nëse ata vlerësojnë së restoranti i ka minimalisht 3 standardet e kërkuara, atëherë do ta certifikojnë Restorantin dhe do lejojë të përdorë logon. Një herë në vit, të paktën dy anëtarë të komisionit do të vizitojnë restorantin, për të vlerësuar mirëmbajtjen e vazhdueshme të zonës së fëmijëve.

Elementet e një restoranti miqësor për fëmijët

Elementet dhe treguesit e një restoranti miqësor për fëmijët janë:

	<i>Treguesi</i>	<i>Standardet minimale</i>	<i>Të detyrueshme kundjet opsionale</i>
1	WIFI miqësor me fëmijët		E detyrueshme
2	Një mjedis specifik brenda restorantit për fëmijët. Mjedisi duhet të ketë hapësirë për të paktën 4 fëmijë dhe duhet të ketë kënd shikimi nga prindërit dhe stafi i restorantit. Mjedisi duhet të jetë i mbrojtur nga rreziqet (elektriciteti, cepa të mprehur, etj) Mosha 6-10 vjec	<ol style="list-style-type: none"> 1. Mjedisi pa reziqe (elektriciteti, cepa, detegjentë apo kimikate të tjera) 2. Tavolina të përshtatura për moshën dhe/ose vetëm për qëndrimin ulur 3. Libra për moshën e duhur dhe /ose libra vizatimi (lapsa dhe bojra) 4. Lodra për moshën (të paktën 2 lloje lodrash) 	E detyrueshme
3	Karrige të larta për fëmijë e moshës 0-2 vjec	<ol style="list-style-type: none"> 1. Karrige e lartë specifike për fëmijë, për t'u ulur me të rriturit 2. Karrigja e lartë respekton rregullat e sigurisë 3. Karriget e larta mirëmbahen vazhdimisht 	Opsionale
4	Menu për fëmijë, me ushqim të përshtatur për fëmijët (të paktën 4 opsione)	<ol style="list-style-type: none"> 1. Propozohet menuja për fëmijë, pa (ose me një sasi të arsyeshme) sheqer dhe yndyrë 	Opsionale

		2. Procesi i gatimit respekton udhëzimet kombëtare të ushqimit për fëmijët	
5	Një kënd lojrash me të paktën 2 zgjedhje (lodra, materiale për fëmijë, dhe për art)	<p>1. Kënd lojrash jashtë i mbrojtur nga ndërhyrjet e jashtme</p> <p>2. Materialet i respektojnë rregullat e sigurisë dhe mirë mbahen vazhdimisht</p>	Opsionale

Zona në funksion të fëmijëve duhet të jetë e izoluar nga pjesa tjetër e restorantit me mobilje, elementët tjerë ose mund të jetë një dhomë e restorantit. Dyert, në këtë rast, duhet të jenë gjithmonë të hapura. Fëmijët nuk lejohen të hanë në zonën e fëmijëve. Ata mund të darkojnë me familjen në restorant dhe mund të qëndrojnë në zonën e fëmijëve para dhe pas darkës. Stafit duhet të mësohet të sillet siç duhet me fëmijët.

[Përfitimi që sjell certifikata Restorant Mik i fëmijëve](#)

Certifikimi i restorantit si i përshtatshëm për fëmijët sjell një sërë përfitimesh:

- **Reputacioni:** një restorant miqësor për fëmijët është pjesë e një projekti më të gjerë të qytetit, i cili është i përkushtuar për t'u ofruar fëmijëve mundësitë më të mira të argëtimit;
- **Ulja e taksave.** Në këtë rast, bashkia duhet të vendosë nëse ofron një ulje të taksës me një nivel, për ata që janë të certifikuar, apo një ulje tatimore me dy nivele. Për shembull, 4% për restorantin e certifikuar (ato që tregojnë 3 elementë të listës), dhe 6% për "premium" të certifikuar (Restorante që kanë të gjithë elementët e renditur më sipër). Ulja e taksave në dy nivele është një nxitje e mirë, por duhet të kontrollohet me zyrën financiare të bashkisë nëse kjo është e mundur, sepse gjeneron një punë të madhe për profesionistët përgjegjës të procesit.
- **Promovimi.** Duke u bërë pjesë e broshurës dhe faqes së internetit të iniciativës, dhe vlerësuar si restoranti mik i fëmijëve, Bashkia do të promovijë këta restorante në zyrat turistike dhe në vende të tjera.

SEKSIONI 5 – RAPORTIMI VJETOR I INICIATIVËS: FORMAT I THJESHTUAR

1. Përshkrim i Situatës
 - a. Arritjet Kryesore
 - b. Sfidat e hasura
2. Arritjet sipas cdo objektive
 - a. Arritjet e aktiviteteve të Objektivit 1
 - b. Arritjet e aktiviteteve të Objektivit 2
 - c. Arritjet e aktiviteteve të Objektivit 3
 - d. Arritjet e aktiviteteve të Objektivit 4
3. Arritja e treguesve kryesorë
4. Ndryshime të nevojshme në Planin e aktiviteteve
5. Raportimi i realizimit buxhetor

SEKSIONI 6 – LISTA E PIKAVE FOKALE TË ZBATIMIT TË PLANIT

Personat e mëposhtëm janë pikat fokale/kontribuesit nga bashkia në zbatimin dhe monitorimin e planit të aktiviteve. Personat janë grupuar sipas objektivave.

Objektivi 1:

- Rudina Lako (Bashkia Korçë) - Koordinatorë e iniciativës, përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e iniciativës
- Anila Bitraku (Përgjegjëse sektori Monitorimi i kurrikulës dhe zhvillimit profesional, ZVA) - Përgjegjëse dhe monitoruese e aktiviteve në institucionet arsimore.
- Mariana Jorgji (Drejtoreshë e Drejtorisë së Kujdesit Social, Bashkia Korçë) - Pjesë e hartimit të planit social të Bashkisë, monitorimit të zbatimit të tij dhe raportimit për ecurinë.
- Nertila Lika (NJMF, Bashkia Korçë) - Raportim për zbatimin e të drejtave të femijëve.
- Larisa Katundi (Drejtoreshë drejtorie e marrëdhënieve me publikun dhe informimin qytetar, Bashkia Korçë) - Botimi vjetor i statistikave me fokus fëmijëve dhe adoleshentëve në Korçë

Objektivi 2:

- Albert Nika (NSHP, Bashkia Korçë) - Rifreskimi vjetor i hartëzimit të ambienteve publike
- Rudina Lako (Bashkia Korçë) - Koordinatorë e iniciativës, përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e iniciativës
- Anila Bitraku (Përgjegjëse sektori Monitorimi i kurrikulës dhe zhvillimit profesional, ZVA)
- Anjeza Vila Universiteti (Departamenti i Edukimit dhe Psikologjisë së Zhvillimit) - Rritja e ndërgjegjësimit të komuniteteve rreth aftësisë së kufizuar
- Mariana Jorgji (Drejtoreshë e Drejtorisë së Kujdesit Social, Bashkia Korçë) - Organizmi, monitorimi dhe shtimi i numrit të femijëve pjesëmarrës në kampin veror “Miqësia”
- Luis Qirinxhi (Bashkia Korçë) - Përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e aktiviteve edukuese/argetuese për fëmijët nga komunitetet vulnerabile tek qyteza e femijëve
- Stivi Simaku (World Vision) - Përgjegjës për organizimin dhe monitorimin e aktiviteve edukuese/argetuese për fëmijët nga komunitetet vulnerabile tek qyteza e femijëve
- Mariela Baraku (Drejtoreshë e Misionit Emanuel) - Zhvillimi i modelit të prindërimit dhe trainimi i të gjithë specialistëve/ofruesve të shërbimit mbi programin e prindërimit pozitiv
- Stivi Simaku (World Vision) - Zhvillimi i modelit të prindërimit dhe trainimi i të gjithë specialistëve/ofruesve të shërbimit mbi programin e prindërimit pozitiv

- Eva Tare (Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi) - Aktivitete ndërgjegjësuese për prindërit dhe fëmijët për rolin e institucioneve të pavarura që mbrojnë të drejtat e fëmijëve

Objektivi 3:

- Rudina Lako (Bashkia Korçë) - Koordinatore e iniciatives, përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e iniciatives
- Anila Bitraku (Përgjegjëse sektori Monitorimi i kurrikules dhe zhvillimit profesional, ZVA) - Përgjegjëse dhe monitoruese e aktiviteteve në institucionet arsimore.
- Megi Duro (Përgjegjëse në Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit, Bashkia Korçë) - Përgjegjëse për monitorimin e internetit të sigurt në mjediset publike
- Zhaneta Lubonja (drejtore e drejtorise së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, Bashkia Korçë) - Shtimi dhe mirembajtja e hapësirave të gjelbra, sinjalistika në mjediset publike
- Albert Nika (NShP, Bashkia Korçë) - Shtimi dhe mirembajtja e hapësirave të gjelbra, sinjalistika në mjediset publike

Objektivi 4:

- Kletion Kita, Nën Kryetar i bashkisë Korçë, Lehtësimi fiskal i bizneseve
- Stivi Simaku, World Vision, për ecurinë e aktiviteteve të aftësisë për jetën
- Luis Qirinxhi (Bashkia Korçë) - Sigurimi dhe monitorimi i standarteve për garantimin e sigurisë ndaj fëmijëve dhe trajnimit të stafit
- Zhaneta Lubonja (drejtore e drejtorise së planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit të territorit, Bashkia Korçë) - Hartimi dhe monitorimi i zbatimit të planit të ndërtimit dhe rinovimit të këndeve të lojtrave
- Megi Duro (Përgjegjëse në Sektorin e Teknologjisë dhe Informacionit, Bashkia Korçë) - Zhvillimi i akademisë ICT
- Rudina Lako (Bashkia Korçë) - Koordinatore e iniciatives, përgjegjëse për koordinimin dhe monitorimin e iniciatives
- Anila Bitraku (Përgjegjëse sektori Monitorimi i kurrikules dhe zhvillimit profesional, ZVA) - Përgjegjëse dhe monitoruese e aktiviteteve në institucionet arsimore.
- Stivi Simaku (World Vision) - Trajnimi i fëmijëve dhe adoleshentëve për aftësitë e jetës, sipërmarrjes sociale, kuptimin dhe përdorimin e medias
- Mariela Baraku (Drejtoreshë e Misionit Emanuel) - Trajnimi i fëmijëve dhe adoleshentëve për aftësitë e jetës, sipërmarrjes sociale, kuptimin dhe përdorimin e medias
- Nertila Lika (NJMF, Bashkia Korçë) - Raportim për zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

SEKSIONI 7 – PLANI I THJESHTË I KOMUNIKIMIT

Aktiviteti	Lloji i kanalit/frekuenca	Përgjegjësia
Informimi rreth aktiviteteve kryesore të iniciativës	Media sociale (Facebook, Youtube, Instagram), media vizive, media online Sa herë ndodh aktiviteti	Bashkia, Partnerë
Shpërndarja e mesazheve kryesore në lidhje me zbatimin e iniciativës	Media sociale (Facebook, Youtube, Instagram), media vizive, media online Sipas një kalendari të zhvilluar nga ekipi zbatues	Bashkia, Partnerë
Raportimi i rezultateve sipas objektivave të iniciativës	Media sociale (Facebook, Youtube, Instagram), media vizive, media online Sipas një kalendari të zhvilluar nga ekipi zbatues	Bashkia, Partnerë
Zhvillimi i materialeve/produkteve promovuese	Video promovuese, fletëpalosje, broshura Sipas një kalendari të zhvilluar nga ekipi zbatues	Bashkia, Partnerë
Matja e ndikimit/arrijtes së mesazheve	Media sociale (Facebook, Youtube, Instagram), media vizive, media online	Bashkia, Partnerë

SEKSIONI 8 – INSTRUMENTAT PER MATJEN E PERCEPTIMEVE

Instrumenti për Vetëvlerësimin e Komunitetit Miqësor për Fëmijët Për fëmijë / të rinj






Sa vjeç jeni? Jeni...?






Mosha



Veçirë











ose










Diellë











Loja & Aktivitetet e mia kulturore		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	1. Në komunitetin tim ka hapësira për lojëra, ndeshje dhe sporte.				
	2. Kam mjaftueshëm kohë për të luajtur, për të pushuar dhe për t'u argëtuar.				
	3. Në komunitetin tim ka hapësira që mund të përdoren nga fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.				
	4. Në komunitetin tim ka hapësira ku unë mund të jem në kontakt me natyrën.				
	5. Unë marr pjesë dhe shikoj festivale dhe evenimente kulturore.				







Pjesëmarrja & Qytetaria ime		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	1. Nëpërmjet projekteve unë ndihmoj për të ndryshuar komunitetin tim.				
	2. Përfshihem në planifikimin dhe vendimmarrjen për komunitetin.				
	3. Mendimet e mia për jetën dhe komunitetin tim merren parasysh nga qeveria* *Këshilli i qyteti, kryetari i bashkisë, etj.				
	4. Kam dëgjuar për të drejtat e fëmijëve në televizione apo radio publike.				
	5. Kam akses në internet dhe ndihem i përditësuar me atë që ndodh përtej komunitetit tim.				

Siguria & Mbrojtja ime		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	1. Ndhem i sigurtë kur përdor autobusin ose mjetet e tjera të transportit publik.				
	2. Është e sigurtë që të eci ose të ngas biçikletën në komunitetin tim.				

	<p>3. Unë e di se ku të raportoj dhe ku të kërkoj ndihmë nëse ndihem në rrezik.</p>				
	<p>4. Unë e di se çfarë të bëj nëse në komunitetin tim ka rrezik ose katastrofa.</p>				
	<p>5. Unë i di rreziqet e përdorimit të internetit.</p>				
	<p>6. Ndihem i sigurtë kur jam “pre” e bullizmit nga fëmijë të tjerë.</p>				
	<p>7. Ndihem i mbrojtur nga bandat/grupet e armatosura.</p>				
	<p>8. Ndihem i mbrojtur kur largohem me një person të huaj (të panjohur).</p>				
	<p>9. Ndihem i sigurtë nga dhuna dhe abuzimi.</p>				
	<p>10. Ka të rritur, që nuk janë pjesë e familjes sime, me të cilët mund të flasë lirshëm për abuzimin ose dhunën.</p>				
	<p>11. Unë besoj se fëmijët e respektojnë njëri-tjetrin në shkollën time, pa u rrezikuar nga të qenit i ngacmuar ose “pre” e bullizmit.</p>				
	<p>12. Ndihem i mirëpritur dhe i përfshirë në komunitetin tim dhe shkollën time.</p>				

Shëndeti im		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	1. Kur jam sëmurë, unë mund të shkoj për kontrolle shëndetësore në komunitetin tim.				
	2. Kam mjaftueshëm ushqim të shëndetshëm për të konsumuar.				
	3. Në shtëpi, kam mjaftueshëm ujë të pastër për të pirë.				
	4. Në shtëpi, kam tualet të pastër për ta përdorur.				
	5. Në shtëpi, kam mjaftueshëm ujë për larje.				
	6. Ndhem i sigurtë në shtëpi.				
	7. Në komunitetin tim, unë mund t'i përdor tualetet publike lehtësisht dhe në mënyrë të sigurtë.				
Mjedisi im		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
	1. Në komunitetin tim nuk ka plehra ose ujëra të ndotura në rrugë.				
	2. Në komunitetin tim ajri është i pastër, nuk ka tym dhe nuk mban aromë të pakëndshme.				

Arsimimi im		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	1. Unë shkoj në shkollë rregullisht.				
	2. Djemtë dhe vajzat trajtohen në të njëjtën mënyrë në shkollë.				
	3. Mësuesit më kushtojnë vëmendjen e duhur.				
	4. Në shkollë mësoj se si të jem i shëndetshëm.				
	5. Në shkollë mësoj se si ta mbroj mjedisin.				
	6. Kam mësuar për <i>Konventën e të Drejtave të Fëmijëve</i> dhe se cilat janë të drejtat e mia.				
	7. Unë besoj se idetë e mia dëgjohen nga mësuesit në shkollën time.				
	8. Në shkollë, kam kohë të lirë për të luajtur lojëra dhe sporte, për të pushuar dhe për të kaluar kohë me shokët.				
	9. Në shkollën time ka mjaftueshëm ujë të mirë për të pirë dhe për t'u larë.				
	10. Në shkollën time ka tualete të pastra, të cilat mund t'i përdor lehtësisht dhe në mënyrë të sigurtë.				

	<p>11. Në shkollën time ka të rritur me të cilët ndihem i sigurtë për të folur për problemet dhe ndjenjat e mia.</p>				
	<p>12. Në shkollën time respektohen të gjithë fëmijët.</p>				
	<p>13. Në shkollën time, fëmijët me aftësi të kufizuara respektohen dhe u jepet trajtim i barabartë.</p>				
	<p>14. Në shkollën time ka disiplinë të tillë që të mos lëndohem fizikisht.</p>				
	<p>15. Më jepen mundësi që të shpreh opinionin tim për vendimet që lidhen me shkollën.</p>				
	<p>16. Shkolla ime mundëson pranimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.</p>				

Instrumenti për Vetëvlerësimin e Komunitetit Miqësor për Fëmijët






Për prindërit e fëmijëve në moshë shkollore

Sa vjeç jeni? A është/janë fëmijët tuaj?






Mosha




Vajzë










apo Djalë

Loja & Aktivitetet kulturore të fëmijëve të mi	Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
	✓	✓	✓	
 <p>6. Në komunitetin tim, fëmijët e mi kanë hapësira lojëra, ndeshje dhe sporte.</p>				
 <p>7. Fëmijët e mi kanë mjaftueshëm kohë për tëhuajtur, për të pushuar dhe për t'u argëtuar.</p>				
 <p>8. Në komunitetin tim ka hapësira që mund të përdoren nga fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.</p>				
 <p>9. Në komunitetin tim ka hapësira ku fëmijët e mi mund të jenë në kontakt me natyrën.</p>				
 <p>10. Fëmijët e mi marrin pjesë dhe shikojnë festivale dhe evenimente kulturore.</p>				








	Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	
--	-----------------	-----------------------	--------------------------	--



Pjesëmarrja & Qytetaria e fëmijëve të mi		✓	✓	✓	Komente
	6. Nëpërmjet projekteve, fëmijët e mi ndihmojnë për të ndryshuar komunitetin tim.				
	7. Fëmijët e mi përfshihen në planifikimin dhe vendimmarrjen për komunitetin.				
	8. Mendimet e fëmijëve të mi për jetën dhe komunitetin tim merren parasysh nga qeveria* *Këshilli i qytetit, kryetari i bashkisë, etj.				
	9. Fëmijët e mi kanë dëgjuar për të drejtat e fëmijëve në televizione apo radio publike.				
	10. Fëmijët e mi kanë akses në internet dhe ndihen të përditësuar me atë që ndodh përtej komunitetit tim.				










Siguria & Mbrojtja e fëmijëve të mi		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	13. Fëmijët e mi ndihen të sigurtë kur përdorin autobusin ose mjetet e tjera të transportit publik.				
	14. Është e sigurtë që fëmijët e mi të ecin ose të ngasin biçikletën në komunitetin tim				
	15. Fëmijët e mi dinë se ku të raportojnë dhe ku të kërkojnë ndihmë nëse ndihen në rrezik.				




	16. Fëmijët e mi dinë se çfarë të bëjnë nëse në komunitetin tonë ka rrezik ose katastrofa.				
	17. Fëmijët e mi i dinë rreziqet e përdorimit të internetit,				
	18. Fëmijët e mi ndihen të sigurtë kur janë “pre” e bullizmit nga fëmijë të tjerë.				
	19. Fëmijët e mi ndihen të mbrojtur nga bandat/grupet e armatosura.				
	20. Fëmijët e mi ndihen të mbrojtur kur largohen me një person të huaj (të panjohur).				
	21. Fëmijët e mi ndihen të sigurtë nga dhuna dhe abuzimi.				
	22. Ka të rritur, që nuk janë pjesë e familjes sime, me të cilët fëmijët e mi mund të flasin për abuzimin ose dhunën.				
	23. Unë besoj se në shkollën ku shkojnë fëmijët e mi, fëmijët e respektojnë njëri-tjetrin, pa u rrezikuar nga të qenit i ngacmuar ose “pre” e bullizmit.				
	24. Fëmijët e mi ndihen të mirëpritur dhe të përfshirë në komunitetin tim.				

Shëndeti i fëmijëve të mi	Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
	✓	✓	✓	

	8. Kur janë sëmurë, fëmijët e mi mund të shkojnë për kontrollë shëndetësore në komunitetin tim.				
	9. Fëmijët e mi kanë mjaftueshëm ushqim të shëndetshëm për të konsumuar.				
	10. Në shtëpi, fëmijët e mi kanë mjaftueshëm ujë të pastër për të pirë.				
	11. Në shtëpi, kemi tualet të pastër që fëmijët e mi të mund ta përdorin.				
	12. Në shtëpi, kemi mjaftueshëm ujë për larje.				
	13. Fëmijët e mi ndihen të sigurtë në shtëpi.				
	14. Në komunitetin e tyre, fëmijët e mi mund t'i përdorin tualetet publike lehtësisht dhe në mënyrë të sigurtë.				

Mjedisi i fëmijëve të mi		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
	1. Në komunitetin tim nuk ka plehra ose ujëra të ndotura në rrugë.				
	2. Në komunitetin tim ajri është i pastër, nuk ka tym dhe nuk mban aromë të pakëndshme.				

Arsimimi i fëmijëve të mi		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
	17. Fëmijët e mi shkojnë në shkollë rregullisht.	✓	✓	✓	
	18. Djemtë dhe vajzat trajtohen në të njëjtën mënyrë në shkollën ku shkojnë fëmijët e mi.				
	19. Mësuesit u kushtojnë fëmijëve të mi vëmendjen e duhur.				
	20. Në shkollë, fëmijët e mi mësojnë se si të jenë të shëndetshëm.				
	21. Në shkollë, fëmijët e mi mësojnë se si ta mbrojnë mjedisin.				
	22. Fëmijët e mi kanë mësuar për Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe se cilat janë të drejtat e tyre.				
	23. Idetë e fëmijëve të mi dëgjohen nga mësuesit në shkollën e tyre.				
	24. Në shkollë, fëmijët e mi kanë kohë të lirë për të luajtur lojëra dhe sporte, për të pushuar dhe për të kaluar kohë me shokët e tyre.				
	25. Në shkollën e fëmijëve të mi ka mjaftueshëm ujë të mirë për të pirë dhe për t'u larë.				

Arsimimi i fëmijëve të mi		Aspak e vërtetë	Pak a shumë e vërtetë	Përgjithësisht e vërtetë	Komente
		✓	✓	✓	
	<p>26. Në shkollën e fëmijëve të mi ka tualete të pastra, të cilat ata mund t'i përdorin lehtësisht dhe në mënyrë të sigurtë.</p>				
	<p>27. Në shkollën e tyre ka të rritur me të cilët fëmijët e mi ndihen të sigurtë për të folur për problemet dhe ndjenjat e tyre.</p>				
	<p>28. Në shkollën e fëmijëve të mi respektohen të gjithë fëmijët.</p>				

SEKSIONI 9 – MEMORANDUMI I MIREKUPTIMIT